IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Prill 2026

Përurimi i Muzeut Arkeologjik, Durrës

Vijojnë Gërmimet Arkeologjike, Kodra e Pusit, Murrizë, Lushnje

18 Prill - Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike

Inspektim në terren, Ura e Haxhi Beqarit, Polis, Elbasan

Parku Arkeologjik i Orikumit - pasuri kulturore e paluajtshme

Bashkëpunim me Universitetin Polis, aktivitet praktik në terren

Restaurim, Sinagoga historike e Sarandës

Konservim, Kisha e Profetit Ilias, Lekël, Tepelenë

Ndërhyrje të integruara për zhvillimin e ofertës turistike kulturore dhe agroturistike, Konispol

Konservim-Restaurim Kalaja e Borshit

Angazhim mbi rijetëzimin e banesave monument kulture, Shkodër

Botimi nr. 04

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Përurimi i Muzeut Arkeologjik, Durrës

Një moment historik për Muzeun Arkeologjik të Durrësit dhe për vetë qytetin të cilit i rikthehet një hapësirë tërësisht e transformuar dhe e investuar në ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë sonë kulturore. Me standarde të reja funksionimi, kushte të përmirësuara dhe një ekspozitë të rikonceptuar po i kthejmë Durrësit dhe publikut një muze të ri, të restauruar plotësisht, thuajse të lindur prej fillimi, ku mbi 3200 artefakte rrëfejnë në mënyrë tejet elegante të shkuarën në pavionët e rikonceptuar, me një linjë të re muzeale që nxjerr në pah temat kryesore të narrativës së muzeut dhe periudhat kryesore historike si dhe parashikon të pasurojë e përditësojë ekspozimin me gjetje, ku spikat mbi të gjitha Bukuroshja e Durrësit, kthyer në shtëpi! Ky projekt, i realizuar në bashkëpunim me Bashkimin Europian përmes programit EU4Culture, zbatuar nga UNOPS është një dëshmi e qartë e angazhimit për të mbrojtur identitetin tonë dhe për ta kthyer atë në një aset zhvillimi për të ardhmen.

Muzeu hap dyert për publikun me hyrje të lirë për 15 ditët e para, si një ftesë për të gjithë vizitorët që të rikthehen dhe ta përjetojnë këtë hapësirë të re të kujtesës dhe dijes.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Vijojnë Gërmimet Arkeologjike, Kodra e Pusit, Murrizë, Lushnje

Gërmimet arkeologjike vijojnë intensivisht në Kodrën e Pusit, pranë fshatit Murrizë (Lushnje), ku po zbulohen gradualisht themelet e një ndërtese me përmasa të mëdha.

Të dhënat e deritanishme tregojnë se zona ka qenë e banuar në periudhën e Antikitetit të Vonë, duke sjellë informacione të vlefshme mbi zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të saj.

Gërmimet do të vijojnë për të zbuluar më shumë detaje rreth funksionit të godinës dhe kontekstit të saj kulturor.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

18 Prill - Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike, IKTK, Qendra Muzeore Durrës dhe Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së Bashku” mundësuan një vizitë edukative për fëmijët në Amfiteatrin e Durrësit.

Fëmijët u njohën nga afër me historinë dhe vlerat e këtij monumenti unik, të ndërtuar në shek. II pas Krishtit gjatë periudhës romake, dikur ndër më të mëdhenjtë në Ballkan.

Aktivitete të tilla synojnë të edukojnë e ndërgjegjësojnë brezin e ri me rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, duke e kthyer historinë në një përvojë të gjallë dhe të prekshme.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim në terren, Ura e Haxhi Beqarit, Polis, Elbasan

Si pasojë e uljes së nivelit të lumit Shkumbin, u bë i mundur për herë të parë dokumentimi i plotë i gjurmëve të Urës së Haxhi Beqarit.
Specialistët e IKTK-së realizuan dokumentimin e saj pranë fshatit Polis, në lindje të Elbasanit, përgjatë aksit drejt Librazhdit dhe Ohrit.

Monument kulture i kategorisë I-rë (1984), ura ishte një pikë kyçe e kalimit të rrugës Egnatia mbi Shkumbin. Me tre harqe të mëdhenj dhe ndërtim prej guri të përforcuar me elementë metalikë, sot ruhen vetëm rrënojat, të dokumentuara edhe përmes fotografive të vjetra.

Studimet tregojnë se ajo është ngritur mbi themele të një ure romake të shek. II–III, duke dëshmuar vazhdimësinë e këtij aksi ndër shekuj.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Parku Arkeologjik i Orikumit
Pasuri kulturore e paluajtshme

Miratuar nga Këshilli i Ministrave, ky vendim forcon kuadrin ligjor dhe institucional për administrimin e një prej siteve më të rëndësishme arkeologjike në vend, duke garantuar ruajtjen e vlerave historike, duke e trajtuar atë si një njësi të pavarur menaxhimi dhe duke garantuar një qasje më të specializuar për ruajtjen, studimin dhe promovimin e tij.

Në thelb të këtij projektvendimi qëndron miratimi i zonifikimit të parkut në dy zona kryesore, Zona A dhe Zona B, të cilat përcaktojnë nivele të ndryshme mbrojtjeje dhe ndërhyrjeje. Zona A përfshin bërthamën e qytetit antik dhe gëzon nivelin më të lartë të mbrojtjes, ku lejohen vetëm ndërhyrje konservuese, restauruese dhe kërkime shkencore. Ndërkohë, Zona B përfshin hapësirat përreth me potencial arkeologjik, ku ndërhyrjet zhvillimore mund të realizohen vetëm në mënyrë të kontrolluar dhe pas vlerësimeve përkatëse. Ky zonifikim krijon një ekuilibër të qëndrueshëm të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.








IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunim me Universitetin Polis, aktivitet praktik në terren

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Polis, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë (DRTK Tiranë), u zhvillua një aktivitet praktik në terren, i fokusuar në rilevimin arkitektonik të objekteve të trashëgimisë kulturore. Ky angazhim shërben si një hap i rëndësishëm paraprak për zhvillimin e mëtejshëm të projekteve të përbashkëta, duke synuar avancimin e tyre deri në fazat konkrete të zbatimit.

Të organizuar në grupe, studentët u angazhuan në rilevimin e një sërë objektesh të rëndësishme të trashëgimisë kulturore me vlera kombëtare, si: Banesa Toptani–Libohova, Sarajet e Toptanasve, Kalaja e Tiranës, Kalaja e Petrelës, Teqeja e Sheh Dyrrit dhe Banesa e Shijakasve.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim,
Sinagoga historike e Sarandës

Sarandë, në Sinagogën historike, një sit unik, i zbuluar nga gërmimet arkeologjike dhe i pasur me mozaikë me vlera të rralla, ku shumë shpejt do të nisë një investim gjithëpërfshirës, që synon restaurimin dhe konservimin e monumentit, mbrojtjen e mozaikëve, sistemin modern të ndriçimit, modernizimin e zyrës së informacionit dhe infrastrukturës së nevojshme për vizitorët, falë një bashkëpunimi konkret mes Bashkisë, Ministrisë së Kulturës, Turizmit dhe Sportit dhe mbështetjes së Fondacionit Besa.

Ky fondacion, i lidhur ngushtë me historinë e besës shqiptare dhe mbrojtjen që populli ynë u bëri hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, sjell një kontribut të vyer edhe për këtë monument me simbolikë të veçantë. Synimi është një ndërhyrje cilësore që do t'i rikthejë shkëlqimin e munguar, që të jetë i aksesueshëm gjatë gjithë ditës dhe natës, si dhe për ta kthyer sa më shpejt këtë sit në një pikë dinjitoze vizitueshmërie për qytetin.




IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Konservim,
Kisha e Profetit Ilias, Lekël, Tepelenë

Ka nisur puna për restaurimin e Kishës së Profetit Ilias, Lekël, Tepelenë, e dëmtuar nga zjarret e vitit të kaluar, përmes një ndërhyrje të rëndësishme që synon rikthimin e këtij Monumenti Kulture në gjendjen e tij origjinale duke ruajtur vlerat historike e arkitektonike. Falë angazhimit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, po realizohen punime konservuese, që përfshijnë rindërtimin e çatisë tradicionale, konsolidimin e strukturës dhe restaurimin e elementëve karakteristikë të objektit.

Ky proces rimekëmbjeje nënvizon edhe rëndësinë e strategjive të mirëstrukturuara dhe të koordinuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga rreziqet natyrore dhe ndryshimet klimatike. Përfshirja e sektorëve të ndryshëm, nga institucionet e trashëgimisë dhe emergjencave civile, te planifikimi territorial dhe bashkëpunimi solidar, janë thelbësore për parandalimin, reagimin dhe rikuperimin e monumenteve, duke garantuar që këto pasuri të çmuara të ruhen për sot, për komunitetin, për interesin që ngjallin tek vizitorët vendas e të huaj, dhe për brezat e ardhshëm.








IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Ndërhyrje të integruara për zhvillimin e ofertës turistike kulturore dhe agroturistike, Konispol

Konispoli po hyn në një fazë të re zhvillimi e cila do ta shndërrojë atë në një pol turistik dhe kulturor. Përmes bashkëpunimit të koordinuar institucional ndërmjet MTKS, Bashkisë Konispol, IKTK dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi implementuese, me një investim prej 500 milionë lekësh të parashikuar në Programin Operacional 2026–2029 të FSHZH-së, për projektin "Ndërhyrje të integruara për zhvillimin e ofertës turistike kulturore dhe agroturistike – Rajoni 4". Kjo ndërhyrje përfshin krijimin e një kompleksi muzeal dhe zhvillimin e ofertës agroturistike në Konispol. Ky investim synon jo vetëm ruajtjen e trashëgimisë, por edhe transformimin e saj në një motor zhvillimi ekonomik dhe social për zonën, duke e kthyer Konispolin në një destinacion të rëndësishëm historik dhe komunitar.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Konservim
Restaurim Kalaja e Borshit

Vijojnë punimet për një ndërhyrje të rëndësishme që do t'i japë jetë të re këtij monumenti historik, duke ruajtur historinë dhe duke përmirësuar përvojën e vizitorëve.

Projekti, i financuar nga Banka Botërore dhe i implementuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, CHwB, IKTK dhe Bashkinë Himarë, parashikon konservimin dhe stabilizimin e strukturave, restaurimin e xhamisë brenda kalasë, si edhe krijimin e elementëve të rinj arkitektonikë, paneleve interpretuese, platformës së vëzhgimit dhe ndriçimit artistik.

Pas përfundimit të punimeve, Kalaja e Borshit do të hapet si sit i ri muzeal me biletë hyrëse, duke u kthyer për herë të parë në një destinacion të mirëstrukturuar për vizitorët.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.